



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M  
NR. 1 DATË 19.04.2013**

**PËR**

**PËRCAKTIMIN SI ZONË E RËNDËSISË KOMBËTARE NË PLANIFIKIMIN E  
TERRITORIT, KOMPLEKSIN “XHAMIA E NAMAZGJASË DHE GODINA  
POLIFUNKSIONALE” NË KRYQËZIMIN E RRUGËS “GEORGE W. BUSH” DHE  
BULEVARDIT “ZHAN D’ARK”, TIRANË.**

Në mbështetje të nenit 6, nenit 8 dhe nenit 32 të Ligjit nr. 10119 dt. 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, Vendimit nr. 87 datë 07.02.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve si dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit

**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**VENDOSI:**

1. Territori i ndodhur në zonën kadastrale nr. 8150 tek ish Namazgjaja, në kryqëzimin e Rrugës “George W. Bush” me Bulevardin “Zhan D’Ark”, shpallet Zonë e rëndësisë kombëtare për karakteristika të veçanta kulturore dhe historike.
2. Miratohet në parim ndërtimi i kompleksit të xhamisë dhe godinës polifunksionale në këtë territor.
3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të shqyrtojë dhe vlerësojë projektin për ndërtimin e këtij kompleksi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**SALI BERISHA**



**ZËVENDËS KRYETAR I KKT**

**SOKOL OLLDASHI**

**MINISTËR I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT**

**SEKRETARE E KKT**

**KREUZA LEKA**

**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**

